

VENDIM
Nr.184/1, datë 14.11.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK "STINËT"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Sefedin Çela	Kryetar
Albert Minga	Zëvendëskryetar
Apostol Noti	Anëtar
Pashk Përvathi	Anëtar
Lazër Stani	Anëtar
Ilir Kulla	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e kërkesës për rilicencim, të paraqitur nga subjekti radiofonik "Radio Stinë", të z.Kujtim Kapollari.

Baza ligjore: Ligji nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", Rregullorja mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", vendimi nr.184, datë 31.10.2003 i KKRT-së "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik "Stinë"

VËREN:

Në mbledhjen e KKRT-së, më datë 31.10.2003 me vendimin nr.184, datë 31.10.2003 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik "Stinë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka vendosur pezullimin e procedurës së rilicencimit për transmetim radio FM vendore private "Stinë", shoqërinë "Stinë" sh.p.k. deri në zgjidhjen e problemeve ligjore midis ortakëve.

Pas njoftimit të subjektit për sa më sipër me shkresën nr.868, datë 3.11.2003, në datën 11.11.2003 u paraqit nga ana e shoqërisë "Stinë" sh.p.k. vendimi nr.17518/3, datë 10.11.2003 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, sipas të cilit ortaku Kujtim Kapollari si përfaqësues i 70% të kapitalit, në datën 5.11.2003 ka shkarkuar administratorin e shoqërisë z.Arqile Ndini, pasi në mënyrë të vazhdueshme, pa vendim të asamblesë së ortakëve ka kryer veprime në dëm të interesave të shoqërisë. Për sa më sipër i është komunikuar z.Arqile Ndini dhe do ta njoftojë sipas ligjit për mbledhje asambleje. Deri në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, ortaku Kujtim Kapollari do të kryejë detyrën e administratorit të shoqërisë.

Bazuar në këto argumente, për kërkesën objekt shqyrtimi të paraqitur nga kërkuksi Kujtim Kapollari, KKRT-ja e gjen atë të drejtë dhe të bazuar në ligj.

PËR KËTË ARSYE,

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.008/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin "Stinë" sh.p.k. për radion "Stinë".

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2003 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela